
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	Zyra e Personelit Kancelarija za Osoblje		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr. 373 /26	Data:17.04.2026	

Bazuar në Nenet 95, 96 dhe 97 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe Rregulloren (Qrk) Nr. 27/2024 për Procedurat e Konkurrimit për Nëpunësit Teknik Dhe Mbështetës, Njësia për Menaxhmin e Burimeve Njerëzore shpall:

KONKURS PËR PRANIM NË MARRËDHËNIE PUNE

Titulli i vendit të punës: Mirëmbajtës

Koeficienti/Paga dhe Klasa: GJ50-Cd_431 - 4.80

Lloji i pozitave: Nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i kërkuar: 1 pozitë

Orari i punës: 40 orë në javë

Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar

Kohëzgjatja e punës provuese: Gjashtë (6)muaj

Institucioni: Komuna Istogut – Drejtoria për Shërbime Publike- Zjarrfikësat

Afati për Aplikim: 18.04.2026- 02.05.2026

Përshkrimi i detyrave të punës :

- Kujdeset për mirëmbajtjen e ndërtesës kryesore dhe brendësisë së saj;
- Mirëmban instalimet elektrike, instalimet e ujësjellësit, nyjet sanitare, inventarin dhe pajisjet e tjera;
- Në rast të prishjeve më të mëdha, mban kontakt me shërbimet e specializuara dhe ndihmon në riparim;
- Ndez dhe fik ngrohjen qendrore dhe gjeneratorin elektrik, duke mbajtur edhe evidencë për derivatet e naftës që ndodhen në rezervuarët e këtyre pajisjeve (varësisht nga lloji i ngrohjes në institucion);
- Në mungesë të ngrohjes qendrore, kujdeset për ndezjen e sobave dhe mirëmbajtjen e tyre, si dhe për sasinë e materialit ngrohës të pranuar (dru, pelet, qymyr, etj.);
- Mirëmban dhe zëvendëson radiatorët e ngrohjes qendrore;
- Mirëmban oborrin e institucionit dhe kujdeset për sipërfaqet e gjelbra, etj.;
- Përcjell punët e shërbimeve për mbushjen e aparateve kundër zjarrit;
- Për punën e tij përgjigjet para drejtorit të institucionit.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Përvojë Pune – Nuk kërkohet

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët :

Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

1. Formulari i aplikimit i plotësuar; rezymja personale(CV)
2. Kopja e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);
3. Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar (prezantohet nga kandidati nëse ai/ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur);
4. Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse (prezantohet nëse kandidati përzgjidhet për emërim);
5. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj);
7. Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar të punës është në sektorin publik, është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati, me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për shkelje të rënda të pushuar sipas Ligjit për Zyrarët Publik;
8. Kopja e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit);
9. Kopja e dëshmisë së punësimit;
10. Kopja e dëshmisë së trajnimeve;
11. Kopja e licencës së punës;

Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën pritëse, QSHQ në Administratën e Komunës së Istogut, në katin përdhese dhe të njejtat me dokumente përcjellëse të dorëzohen në po të njejtën zyre.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Intervista me gojë (deri në 70 pikë)
- Jetëshkrimi CV (deri në 30 pikë)

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare: Përmes web faqes së Komunës së Istogut dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>).

SQARIME SHITESË:

- Kandidati, përmes aplikacionit, deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.
- Deklarimi i rrejtshëm paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.
- Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, ata duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës.
- Komunitetet jo shumicë, personat me aftësi të kufizuara dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet me legjislacionin në fuqi.
- Nëse eventualisht nuk merrni konfirmimin automatikisht për pranim të email-it, atëherë kontaktoni zyret tona.



U.D Menaxher i Personelit

Valentina Bytyçi.